

URDHËR
Nr.505, datë 8.11.2010

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT “MASTER PROFESIONAL” NË
UNIVERSITETIN “EQREM ÇABEJ”, GJIROKASTËR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 26 dhe 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen në Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore të universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, të programeve të studimit “Master profesional” në:
 - a) “Gjuhë dhe qytetërim italian”, me profil minor në “Gjuhë shqipe”;
 - b) “Gjuhë-letërsi dhe qytetërim grek”, me profil minor në “Lëndë shoqërore”.
2. Programet e studimit “Master profesional” realizohen me 90 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 1,5 (një vit e gjashtë muaj) vit akademik.
3. Programet e studimit të fillojnë veprimtarinë mësimore, në vitin akademik 2010-2011.
4. Në përfundim të programeve të studimit lëshohet diploma “Master profesional” në:
 - a) “Gjuhë dhe qytetërim italian”, me profil minor në “Gjuhë shqipe”;
 - b) “Gjuhë-letërsi dhe qytetërim grek”, me profil minor në “Lëndë shoqërore”.
5. Efektet financiare, për zbatimin e këtij urdhri, përballohen nga buxheti i universitetit “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, pa efekte buxhetore shtesë.
6. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj